



Në bazë të dispozitave të nenit 5 të Rregullores për dhënie në shfrytëzim me qira, 01 nr. 361 - 215, të dt. 04.05.2006, dhe në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës për formimin e Komisionit për ndarjen e banesave 01. nr. 020-544, të dt. 23.11.06, pas shqyrtimit të dokumentacionit të pranuar, daljes në terren dhe takimeve të mbajtura nga Komisioni, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 23.10.2007, mori:

V E N D I M PËR DHËNIEN E BANESAVE NË SHFRYTËZIM ME QIRA

Neni 1

Objekt i këtij vendimi është dhënia e banesave me qira, të cilat gjenden në kompleksin afaristo-banesor “Kodra e Diellit”, rruga “Gazmend Zajmi” në Prishtinë.

Neni 2

Jepen në shfrytëzim me qira për 10 vjet banesat kandidatëve si në vijim:

Objekti-2-

Kati i parë: - banesa 2/2. 1.1, 3,5 dhoma, Shemsi Veselit (deputet),
- banesa 2/2. 1.2. 3 dhoma, familjes së Adem Jasharit (familje e dëshmorëve),
- banesa 2/2. 1.3 2,5 dhoma, Sevdaim Vitisë – TMK.

Kati i dytë: - banesa 2/2. 2.1 3,5 dhoma, Naser Gashit (deputet),
- banesa 2/2. 2.2. 3 dhoma, familjes së Agim Ramadanit (familje e dëshmorëve),

Kati i tretë: -banesa 2/2. 3.1 3,5 dhoma, Shefqet Sylejmanit (deputet),
-banesa 2/2. 3.2. 3 dhoma, familjes së Sali Çekajt (familje e dëshmorëve),

Kati i katërt: - banesa 2/2. 4.1 3,5 dhoma, Osman Vitisë (deputet),
- banesa 2/2. 4.2. 3 dhoma, familjes së Ahmet Krasniqit (familje e dëshmorëve).

Objekti 1/2

Kati i parë: - banesa 1 /2. 1.1 2 dhoma, HENDIKOS-it,
- banesa 1/ 2. 1.4 3 dhoma, Fejzë Hysenit (deputet).

Kati i dytë: - banesa 1/2. 2.4 3 dhoma, Xhemajl Gërbeshit (deputet),

Kati i tretë - banesa 1/2. 3.4 3 dhoma, Vesel Veselit (deputet).

Objekti 3

Kati i dytë: - banesa 3.2.2 3 dhoma, Lah Nitajt (deputet),
- banesa 3.2.3 A 2.5 dhoma, Vjollca Rizanit dhe 3.2.3 B 2.5 dhoma Izet Sadikut (deputetë).

Kati i tretë: - banesa 3.3.2 3 dhoma, Sabri Simnicës (deputet).

Objekti 1/3

Kati i parë: - banesa 1/3. 1.1 2 dhoma, SHPK-së, Mazllum Bajraktarit,
- banesa 1/3. 1.4 3 dhoma, Fatmir Sopit, veteran i luftës.

Kati dytë - banesa 1/3.2.4 3 dhoma, familjes së Jusuf Gërvallës.

Kati i tretë - banesa 1/3.3.4 3 dhoma, familjes së Zahir Pajazitit.

Kati i katërt - banesa 1/3.4.4 3 dhoma, familjes së Xhemail Mustafës.

Neni 3

Banesat jepen në shfrytëzim me qira konform Rregullores për dhënien e banesave në shfrytëzim me qira.

Neni 4

Kushtet për dhënien e banesës në shfrytëzim me qira përcaktohen me kontratë të veçantë të lidhur në mes të shfrytëzuesit dhe dhënësit të banesës në shfrytëzim me qira – Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi nga dita e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. Nr. 360-466, më 23.10.2007

KRYETAR I KUVENDIT
Ismet Beqiri